



Bashkia Malësi e Madhe

Plani i Arsimit Parauniversitar në Bashkinë Malësi e Madhe 2026-2028

Plani përbëhet nga 2 pjesë të ndryshme të hartuara në periudha kohore të ndryshme të vitit 2025, Planin e Arsimit Parashkollor me vëmendje të veçantë kopshtet dhe Planin e Arsimit Parauniversitar për shkollat 9 vjecare dhe arsimin e mesëm.

Hyrje dhe konteksti

Konteksti administrativ

Bashkia Malësi e Madhe përfshin një numër njësisish administrative, secila prej të cilave luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin lokal, përfshirë edhe shërbimet e arsimit parashkollor.

Kjo strukturë e përbërë nga 6 njësi administrative përbëhet nga një ndërthurje e zonave urbane dhe rurale, çka ndikon ndjeshëm në mënyrën e organizimit të shërbimeve publike, si dhe në shpërndarjen e burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe financiare.

Prania e diversitetit gjeografik dhe demografik mes njësive administrative kërkon një qasje të diferencuar në planifikimin dhe ofrimin e arsimit parashkollor, për të garantuar akses të barabartë dhe cilësi të njëtrajtshme të shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë.

Aktualisht, Bashkia Malësi e Madhe përfshin gjithsej 6 njësi administrative: Koplik, Qendër, Gruemirë, Kastrat, Kelmend dhe Shkrel., të cilat përbëjnë bazën e ofrimit të shërbimeve publike, përfshirë arsimin parauniversitar, kopshtet dhe shkollat publike.

Të dhëna administrative	Vlerë
Sipërfaqja	951.01km ²
Popullsi bashkisë	21684 (Cens 2023)
Njësi administrative	Koplik, Qendër, Gruemirë, Kastrat, Kelmend dhe Shkrel

Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Malësi e Madhe është 21684 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 10,879 meshkuj dhe 10,805 femra. Struktura e popullsisë karakterizohet nga një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve në moshë parashkollore dhe të rinjve, gjë që nënvizon rëndësinë e zhvillimit dhe forcimit të shërbimeve arsimore në këto kategori. Pjesa më e madhe e popullsisë është e përqendruar në zonën fushore, në Koplik dhe Qendër me 6600 banorë, në njësinë administrative të Gruemirës me 6634 dhe në veri në njësine Administrative të Kastratit 4335 banorë. Në 2 Njësitë Administrative Kelmend dhe Shkrel, njësi me reliev malor banojnë 1464 dhe 2651 banorë.

Kjo përbërje demografike tregon nevojën për një planifikim të kujdesshëm të burimeve arsimore, duke marrë parasysh kërkesën e lartë për shërbime edukimi, veçanërisht në fazat e hershme të zhvillimit të fëmijëve dhe në arsimin e mesëm. Në shumicën e Njësive administrative vihet re një diferencë e lehtë në favor të femrave.

Emri i Njesise Administrative	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Koplik		1 469	1 521
Qendër		1 855	1 755
Gruemirë		3 178	3 456
Kastrat		2 145	2 190
Kelmend		728	736
Shkrel		1 604	1 047

Grupmosha	Numri i banoreve	Meshkuj	Femra
0-4 vjeç	870	438	432
5-9 vjeç	1 005	491	514
10-14 vjeç	1 082	570	512
15-19 vjeç	1 322	655	667

Burimi: Instat 2023

Përshkrim demografik sipas njësive administrative në Bashkinë Malësi e Madhe:

Në kuadër të planifikimit të shërbimeve arsimore parauniversitare, është me rëndësi të kuptohet struktura demografike e popullsisë në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe. Kjo bashki përfshin një përzierje të zonave urbane dhe rurale, ku dinamika e popullsisë ndryshon në varësi të pozicionit gjeografik, infrastrukturës dhe aksesit ndaj shërbimeve publike.

- **Njësia administrative Koplik**, që përfshin qendrën urbane të qytetit, ka një popullsi prej 2981 banorësh, me 1 521 femra dhe 1469 meshkuj. Kjo përfaqëson bërthamën më të madhe urbane demografike të bashkisë dhe ofron infrastrukturën më të zhvilluar arsimore dhe shëndetësore.
- Në njësinë administrative **Qendër**, jetojnë gjithsej 3610 banorë, nga të cilët 1755 janë femra dhe 1855 janë meshkuj. Popullsia është e përqendruar fshatra të vogla, me nevoja të veçanta për akses në shërbime të hershme edukimi, të cilat janë shume afer zones urbane te Koplikut dhe pjesen me te madhe te sherbimeve i marrin aty.
- **Gruemira**, një njësi me karakter historik dhe potencial turistik, numëron gjithsej 6 634 banorë, prej të cilëve 3456 janë femra dhe 3178 meshkuj. Kjo përfaqëson bërthamën e dytë më të madhe urbane demografike të bashkisë dhe ofron infrastrukturën më të zhvilluar arsimore dhe shëndetësore.
- **Kelmend** ka një popullsi prej 1464 banorësh, me një shpërndarje relativisht të balancuar gjinore: 736 femra dhe 728 meshkuj. Kjo njësi ndodhet në një zonë të thellë malore dhe ka nevojë për mbështetje në zhvillimin e shërbimeve të integruara për fëmijët e moshës parashkollore.
- **Shkrel** përfshin 2 651 banorë, nga të cilët 1047 janë femra dhe 1604 meshkuj. Popullsia e shpendare ne fshatra te vegjel në një zona malore dhe ka nevojë për mbështetje në zhvillimin e shërbimeve të integruara për fëmijët e moshës parashkollore.
- **Kastrat** ka një popullsi prej 4 335 banorësh (2190 femra dhe 2145 meshkuj). Për shkak të pozicionit gjeografik dhe zhvillimit më të mirë ekonomik, kjo njësi paraqet kushte më të favorshme për zgjerimin e rrjetit edukativ dhe përfshirjen e grupeve të ndryshme të fëmijëve në sistemin parashkollor.

Pjesa e parë
Arsimi Parashkollor
2026 - 2028

Përmbajtja - Pjesa e parë

Hyrje	
1.1 Qëllimi	
1.2 Shtrirja	
1.3 Vizioni	
1.4 Misioni	
1.5 Objektivat	
1.6 Përgjegjësitë	
2. Proceset e Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	
2.1 Qëllimi i proceseve të menaxhimit	
2.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve të menaxhimit	
2.3 Regjistrimi i fëmijëve	
2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht	
2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor	
2.4.1 Këshilli i prindërve, Bordi i kopshtit, Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit	
3. Proceset Kryesore-Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	
3.1 Qëllimi i proceseve kryesore	
3.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve kryesore	
3.3. Përfshirja sociale	
3.3.1 Identifikimi i nevojave për përfshirje	
3.4 Mbrojtja e fëmijëve	
3.4.1 Mbrojtja e fëmijëve në kopshte	
Përshkrimi i Aktiviteteve/Projekteve	
3.5 Fëmijët me aftësi të kufizuara	
3.5.1 Adresimi i prindërve	
4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	
4.1 Qëllimi i proceseve mbështetëse	
4.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve mbështetëse	
4.3 Burimet Njerëzore	
4.3.1 Rekrutimi i stafit	
4.4 Menaxhimi i godinave	
4.4.1 Rikonstruksioni i objekteve	
4.5 Materialet	
4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale	
5. Buxheti	

Hyrje

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar me Neni 23 “Funkcionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për “Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.” Në këtë kuadër, Bashkia ka hartuar një plan për Përmirësimin e Shërbimit të Arsimit Parashkollor.

Analizimi i situatës dhe përcaktimi i piketave për të ardhmen është ndërmarrë me kontributin e vyer që kanë ofruar mësues dhe drejtues të arsimit parashkollor si me sugjerime gjatë takimeve të hapura konsultuese, ashtu dhe me kontribut shkresor për veprimtaritë e tyre që kontribojnë në arritjen e objektivave të Planit, drejt vizionit për një përmirësim cilësor dhe sasior të shërbimit. Drejtimi metodologjik është mbështetur nga programi “Bashki të Forta”, në kuadër të asistencës së Qeverisë Zvicerane përmes SDCsë, zbatuar nga Smart Processes. Ekspertët e Smart Processes, ka ndërmarrë udhëheqjen metodologjike dhe lehtësimin e takimeve periodike për rrahjen e ideve dhe identifikimin e sfidave, objektivave dhe masave.

Qëllimi i këtij plani është të krijojë një platformë strategjike dhe gjithë përfshirëse që do të vendosë bazat për zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor në sektorin e Arsimit Parashkollor. Arsimi konsiderohet si një sektor me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien sociale dhe ekonomike. Për këtë arsye, është e nevojshme të përmirësohet infrastruktura e kopshteve për të ofruar shërbim cilësor në Arsimin Parashkollor.

Plani i përmirësimit të shërbimit synon të harmonizojë aktivitetet dhe të krijojë një vizion të përbashkët dhe koherent, i fokusuar në objektiva strategjike.

Për të adresuar këto çështje, është e rëndësishme të krijohet një program ndërhyrjesh për zhvillimin e infrastrukturës së arsimit, që synon rritjen e cilësisë dhe standardeve të arsimit parashkollor duke përmirësuar infrastrukturën fizike arsimore. Një nga sfidat kryesore është gjendja e infrastrukturës fizike të institucioneve arsimore në të gjithë vendin.

1.1 Qëllimi

Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Malësi e Madhe dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me arsimin parashkollor. Konkretisht nëpërmjet planit synohet:

- Përmirësimi i shërbimit në kopshtet ku mungojnë regjistrimet në mënyrë që të rriten regjistrimet;
- Planifikim strategjik për sa i përket riorganizimit të infrastrukturës së kopshtit, me qëllim përsimulësimin e shërbimit në kopshtet që janë brenda shkollave, ose kopshteve që kanë nevojë imediate për restaurim;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore të bashkisë në çështje të arsimit parashkollor, përmes ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e drejtimit dhe administratës së bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të përmirësimit;
- Bashkëpunimi i ngushtë me prindërit dhe komunitetin, për të ndërgjegjësuar për rëndësinë që ka kopshti në zhvillimin e fëmijës;

Në pjesën e parë të dokumentit gjendet një analizë përmbajtësore e cila do të përmbajë Vizionin, Misionin, Objektivat Strategjik të Planit, personat përgjegjës për implementimin, monitorimin dhe zhvillimin e tij.

Në pjesën e dytë dokumenti fokusohet në vendosjen e Objektivate të përgjithshëm dhe specifik për secilin proces. Për të lehtësuar procesin e implementimit të planit, janë vendosur edhe indikatorët e performancës si dhe objektivat specifik për secilin kriter të përgjithshëm dhe më pas aktivitetet që duhen ndërmarrë për të arritur objektivat e vendosur.

Ndërkohë në pjesën e tretë është përmbledhur buxheti i nevojshëm për të realizuar ndërhyrjet në terren me qëllim rritjen e cilësisë në arsimin parashkollor.

1.2 Shtrirja

Plani i përmirësimit të shërbimit synon të përmirësojë shërbimin e Arsimit Parashkollor në Bashkinë Malësi e Madhe. Plani do të zbatohet në të gjitha kopshtet që ka nën juridikson Bashkia Malësi e Madhe për një periudhë tre vjeçare, 2026 - 2028. Për mbarëvajtjen e aktiviteteve në plan dhe monitorimin e tij do të kujdeset Drejtoria e Kultures, Arsimit, Sportit, Turizmit dhe Rinisë/Spektori i Kultures dhe Arsimit

1.3 Vizioni

Përmirësimi i shërbimeve të arsimit parashkollor nëpërmjet ngritjes dhe fuqizimit të strukturave të dedikuara, të cilat ofrojnë një edukim cilësor që i përgjigjet nevojave të gjithanshme të fëmijëve, duke krijuar një mjedis të sigurt, zhvillues dhe përgatitor për suksesin e tyre të ardhshëm.

1.4 Misioni

Të përmirësojmë cilësinë e infrastrukturës, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse duke ofruar një shërbim cilësor edukimi dhe mbështetjeje për çdo fëmijë të arsimit parashkollor, me qëllim sigurimin e një zhvillimi të plotë dhe të barabartë për të gjithë.

1.5 Objektivat

- Ulja e numrit të grupeve të përziera në kopshte nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës;
- Ngritja dhe fuqizimi i strukturave mbështetëse të kopshtit (Bordi dhe Këshilli i prindërve, Komisioni shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit)
- Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, me aftësi të kufizuar dhe në nevojë për përfshirje sociale.
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimit në kopshte nëpërmjet organizimit të regjistrimeve sipas vendbanimeve;
- Unifikimi i një seti didaktik
- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i infrastrukturës së kopshteve;

1.6 Përgjegjësitë

1. Koordinator i planit:

Personi përgjegjës për Sektorin e Arsimit parashkollor, i cili kujdeset për zbatimin e planit nga të gjithë aktorët përgjegjës;

2. Aktorët zbatues të planit:

Drejtues të kopshteve, Mësues të kopshteve, Komuniteti, Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF), Psikologu, Grupet Teknike Ndërsektoriale (GTN), Grupet e terrenit.

3. Monitorues/vlerësues i planit: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli i Bashkisë.

2. Proceset e Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

2.1 Qëllimi i proceseve të menaxhimit

Proceset e menaxhimit nuk janë pjesë e ekzekutimit të menjëhershëm të detyrave, por vendosin objektiva strategjike dhe kushte kuadër që ndikojnë në llojet e tjera të procesit. Këto përfshijnë planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë.

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetet në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit. Kjo përbën planifikimin e kërkesës së arsimit parashkollor, duke marrë parasysh që arsimi parashkollor nuk është i detyrueshëm në Shqipëri.

Procesi i parashikimit ka gjithashtu edhe dimensionin e ofertës, që përfshin vlerësimin e numrit të mësuesve të nevojshëm, drejtorëve, mësuesve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, stafit mbështetës, si dhe objekteve (mjediseve), stafit shtesë etj.

Plani i përmirësimit të shërbimit në Proceset e Menaxhimit ka si qëllim përmirësimin e shërbimit të kopshtit duke siguruar ulje të numrit të fëmijëve në kopshtet e mbipopulluara; rritje të regjistrimeve në kopshtet nën kapacitet; ulje të numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në to, dhe themelimin dhe fuqizimin e organizmave brenda institucionit të kopshtit.

2.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve të menaxhimit

Objektivat kryesorë të këtij plani në lidhje me Proceset e Menaxhimit janë:

1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së tyre të banimit dhe rritja e regjistrimeve përmes ndërgjegjësimit të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijës;
2. Krijimi i konceptit të kopshtit si komunitet duke organizuar aktivitete në çdo kopsht ku komuniteti mund të marrë pjesë dhe rritja e angazhimit të komunitetit në përmirësimin e shërbimit të arsimit parashkollor;
3. Themelimi dhe fuqizimi i organizmave si: Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit dhe Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, në mënyrë që të rritet ndikimi i tyre në proceset e menaxhimit të kopshteve.
4. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe zbatimi i ligjit për drejtimin e kopshteve.
5. Rikonstruksioni i kopshteve në bazë të një vlerësimi teknik.

2.3 Regjistrimi i fëmijëve

2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Nenin 23, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e tyre për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe. Ky ligj u jep bashkive të drejtën për të planifikuar, financuar dhe organizuar funksionimin e kopshteve. Po ashtu, bashkitë kanë të drejtën për të përcaktuar rregulla të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme për funksionimin e kopshteve, në përputhje me ligjin.

Objektiva specifike:

Planifikimi i sistemit parashkollor duke u bazuar në numrin e parashikuar të fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, normën e regjistrimit të pritshme dhe shkallën e frekuentimit, për të ofruar një shërbim të efektshëm dhe të qëndrueshëm.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Planifikimi dhe parashikimi për regjistrimin dhe akomodimin e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në kopshtet, duke marrë parasysh numrin e pritur të fëmijëve, normën e regjistrimit dhe shkallën e frekuentimit për të siguruar shërbim efikas dhe të qëndrueshëm.
2	Përmirësimi i shërbimit nëpërmjet krijimit të konceptit të kopshtit si qendër komunitare
3	Rregullimi i procedurës së regjistrimit nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të akteve formale.
5	Ulja e numrit të grupeve të përzier

Lista e Aktiviteteve/Projekteve

Nr.	Projekti
001	Analiza dhe parashikimi i regjistrimeve dhe frekuentimit në shërbimin e Arsimit Parashkollor
002	Regjistrimi i fëmijëve sipas vendbanimit
003	Unifikimi i të dhënave mbi shërbimin e arsimit parashkollor mes bashkisë dhe kopshteve
004	Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve

2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor

2.4.1 Këshilli i prindërve, Bordi i kopshtit, Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit

Në Bashkinë Malësi e Madhe, 16 kopshte e kanë themeluar Bordin e Kopshtit dhe 16 kopshte në NjA Gruemire, Kastrat, Qender, Shkrel dhe Kelmend nuk e kanë themeluar Bordin e Kopshtit pasi këto kopshte janë në varësi të shkollës ku ndodhen dhe shkolla ka Bordin e saj.

- Jo të gjithë kopshtet kanë numrin e anëtarëve sipas përcaktimeve në aktet ligjore, 7 anëtarë.
- Një pjesë e kopshteve në Bashkinë Malësi e Madhe zhvillojnë më pak se 3 mbledhje në vit, normë kjo e përcaktuar në aktet ligjore

Vetëm 23 kopshte e kanë themeluar Këshillin e Prindërve ndërsa 9 kopshte të tjerë nuk e kanë themeluar.

- Jo të gjithë kopshtet kanë numrin e anëtarëve 6-9 anëtarë.

Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit është themeluar në 20 kopshte të Bashkisë Malësi e Madhe dhe 12 kopshte të tjera janë shprehur se nuk e kanë themeluar.

Objektiva specifike:

- Themelimi i Organizmave të Kopshtit
- Fuqizimi i Organizmave të Kopshtit
- Adresimi i problematikave të kopshtit në Bashki nëpërmjet funksionimit të organizmave të kopshtit

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Themelimi i Bordit të Kopshtit sipas Udhëzimit Nr. 25, datë 28.01.2020 ¹ dhe rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Bordit përsa i përket të drejtave dhe detyrimeve të tyre
2	Themelimi dhe fuqizimi i Këshillit të Prindërve në të gjithë Kopshtet veçmas nga Këshilli i Shkollës
3	Adresimi i çështjeve të diskutuara në organizmat e kopshteve në Bashki
4	Themelimi dhe fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në çdo kopsht dhe ndarja e Komisionit të Kopshtit nga ai i Shkollës.

¹ Udhëzimi Nr. 25, datë 25.07.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”.
<https://qbz.gov.al/share/heKG0N0RTu6VE3O1UXEocA>



Bashkia Malësi e Madhe

Lista e Aktiviteteve/Projekteve

Numri	Projekti
005	Themelimi dhe Fuqizimi i Këshillit të Prindërve
006	Themelimi dhe fuqizimi i Bordit të Kopshtit sipas Udhëzimit nr. 25 datë 28.01.2020 ²
007	Themelimi dhe fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit

²Udhëzimit Nr. 25, datë 25.07.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”.
<https://qbz.gov.al/share/heKGONORTu6VE3O1UXEocA>



Bashkia Malësi e Madhe

3.Proceset Kryesore-Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

3.1 Qëllimi i proceseve kryesore

Plani i përmirësimit të shërbimit ka si qëllim rritjen e identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit më të mirë të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, etj), fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe fëmijët me aftësi të kufizuar.

3.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve kryesore

Objektivat kryesore të planeve të përmirësimit në lidhje me proceset kryesore janë:

1. Përmirësimi i procesit të identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuar.
2. Përmirësimi i procesit të menaxhimit të rasteve të identifikuar të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në nevojë për përfshirje sociale dhe me aftësi të kufizuar.

3.3. Përfshirja sociale

3.3.1 Identifikimi i nevojave për përfshirje

Referuar Ligj nr. 18/2017³, neni 50, çdo njësi administrative e bashkisë, e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, ka minimalisht, një punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Në rastet kur njësi administrative e bashkisë ka më pak se 3000 fëmijë, këtë detyrë mund ta kryejë njëri nga punonjësit e njesisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

Referuar Urdhrit nr. 461 dt 27/07/2022 Për një ndryshim në Urdhërin 313 datë 20/10/2020⁴, Shërbimi Psiko-Social (ShPS), Kreu II, pika 4, numri i psikologëve dhe punonjësve socialë në një ShPS, për një ZVAP, përcaktohet nga numri i nxënësve në institucionet arsimore (kopshte, shkolla) në juridiksionin e ZVA-ve:

Objektiva specifike:

- Rritja e identifikimit dhe vlerësimit të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike etj).
- Parandalimi, identifikimi, raportimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Përmirësimi i identifikimit dhe vlerësimi i fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social
2	Zgjerimi i shërbimeve lehtësuese për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti në mënyrë që të nxitet regjistrimi/frekuentimi i tyre në kopsht.
4	Organizimi i paketave trajnuese për stafet e punonjësve për t'u njohur me shërbimet mbrojtëse për fëmijët dhe kryesisht të rolit të tyre në të gjithë këtë proces

³ Ligj nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"

⁴ Urdhëri 461 dt 27/07/2022 Për një ndryshim në Urdhërin 313 datë 20/10/2020 Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko social i ndryshuar.

Lista e Aktiviteve/Projekteve

Nr	Projekti
008	Promovimi i rolit dhe detyrave të PMF
009	Shërbime mbështetëse për familjet me vështirësi ekonomike

3.4 Mbrojtja e fëmijëve

3.4.1 Mbrojtja e fëmijëve në kopshte

Nga të dhënat e mbledhura në nivel Bashkie është raportuar se nuk ka fëmijë në nevojë për mbrojtje, të cilët janë të regjistruar dhe frekuentojnë çdo ditë kopshtin.

Në bashkinë Malësi e Madhe vepron një Njësi për Mbrojtjen e Fëmijës, e organizuar si një njësi speciale brenda strukturës, përgjegjëse për shërbimet sociale që kanë si detyrë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e çështjeve të fëmijëve në rrezik dhe/ ose në nevojë për mbrojtje.

Punonjësi social pranë bashkisë mbulon me shërbim edhe kopshtet në Njësi Administrative, ndërsa psikologët e shkollave ofrojnë shërbim edhe për fëmijët e kopshteve në rastet e kopshteve të cilat ndodhen brenda godinave të shkollave.

Objektiva specifike:

Parandalimi, identifikimi, raportimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve punojnë ngushtësisht me stafet e kopshteve për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve por edhe trajtimin në vazhdimësi të tyre
2	Organizimi i paketave trajnuese për stafet e punonjësve për t'u njohur me shërbimet mbrojtëse për fëmijët dhe kryesisht të rolit të tyre në të gjithë këtë proces
3	Vendosja e punonjësve kontakt për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve në çdo kopsht

Lista e Aktiviteteve/Projekteve

Nr	Projekti
010	Fuqizimi dhe promovimi i një punonjësi të dedikuar në çdo institucion të arsimit parashkollor, i cili do të kujdeset për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucion.
011	Hartimi i posterave/materialeve me përmbajtje tekstesh jo-letrare mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve përshtatur me gjuhën e kuptueshme për fëmijët e kopshteve dhe stafeve pedagogjike në kopshte.

3.5 Fëmijët me aftësi të kufizuar

3.5.1 Adresimi i prindërve

E drejta për arsimim fëmijëve me aftësi ndryshe (të kufizuara) iu garantohet nga Ligji 69/2012, i ndryshuar⁵, Kreu XI, “Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara”, neni 63, pika 2 (citim): “.....Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara **në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore**”. Sipas udhëzimeve ligjore, zakonisht një mësuese ndihmëse ose asistente ofrohet për çdo 2-3 fëmijë me aftësi të kufizuara në një grup ose klasë. Megjithatë, ky raport mund të ndryshojë bazuar në specifikat e nevojave të fëmijëve dhe vendimet e veçanta të institucioneve arsimore dhe njësive administrative përkatëse.

Objektiva kryesore:

- Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar
- Plotësimi i standardeve të aksesueshmërisë të fëmijëve me AK në arsimin parashkollor

Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Përmirësimi i komunikimit mësues-prind gjatë procesit të diagnostikimit të fëmijës nëpërmjet trajnimit të stafit të kopshteve dhe ofrimit të shërbimit psiko-social për prindërit
2	Punësimi i më shumë mësueseve ndihmës për të mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshte
3	Heqja e barrierave që pengojnë aksesueshmërinë e fëmijëve me AK në kopshte

Lista e Aktiviteteve/Projekteve

Nr	Projekti
012	Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me AK përmes mbështetjes psiko-sociale të prindërve dhe mësuesve
013	Vendosja e rampave dhe respektimi i standardeve për infrastrukturën e fëmijëve me AK pranë institucioneve arsimore
014	Rritja e numrit të mësueseve ndihmës

⁵Ligji 69/2012, i ndryshuar, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

4.Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

4.1 Qëllimi i proceseve mbështetëse

Proceset mbështetëse janë procese që ofrojnë mbështetje për proceset kryesore. Proceset mbështetëse duhet të gjenden brenda ose jashtë institucionit. Në shembullin e kopshtit, një proces mbështetës mund të jetë shtimi i burimeve njerëzore pranë Bashkisë, për të koordinuar në aktivitetet e planit të përmirësimit të arsimit parashkollor.

4.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve mbështetëse

Objektivi kryesor i planeve të përmirësimit të shërbimit në lidhje me Proceset Mbështetëse është arritja e standardeve të vendosura nga aktet ligjore përsa i përket numrit të stafit të kopshteve, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave, llojet e materialeve didaktike, cilësinë e ushqimit dhe sigurimin e aksesit në kopësht.

4.3 Burimet Njerëzore

4.3.1 Rekrutimi i stafit

Në kopshtet e Bashkisë ofrojnë shërbimin 48 mësuese dhe 7 staf mbështetës.

Nga 48 mësuese, 1 prej tyre është mësuese ndihmëse. Nëse do të analizojmë numrin e mësueseve për fëmijë, raporti mësuese/fëmijë është: numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike është 543 numri i mësueseve është 48 dhe **numri i fëmijëve për mësuese është mesatarisht 11 fëmijë.**

Në kopshtet e Bashkisë Malësi e Madhe ka vetëm 1 drejtor kopshti, i cili drejton kopshtin Koplik. Në kopshtet e tjera janë mësueset ato të cilat janë përgjegjëse për kopshtin.

Objektiva specifike:

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të kopshteve duke siguruar nivelin e duhur të stafit përcaktuar nga aktet ligjore.

Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Zbatimi i Udhëzimit Nr.14, datë-10.7.2023 ⁶ , sipas të cilit kërkohet të vendoset një drejtor kopshtesh për 5 grupe fëmijë.
2	Përgatitje më e lartë profesionale për mësuesit nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve, në bashkëpunim me institucionet e varësisë, universitetet si dhe me shoqatat e akredituara.

Lista e Aktiviteteve/Projekteve

Nr.	Projekti
015	Zbatimi i Udhëzimit Nr. 14, datë-10.7.2023 ⁷ për punësimin e drejtorit/vë për 5 grupe fëmijësh.
016	Trajnime për stafin e kopshteve për rastet e emergjencave, dhënien e ndihmës së shpejtë shëndetësore.

⁶ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/Udhezim-Nr.14-date-10.7.2023-Per-numrin-e-nxenesve-per-klase-dhe-ngarkesen-mesimore-te-punonjesve-arsimore.pdf>

⁷ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/Udhezim-Nr.14-date-10.7.2023-Per-numrin-e-nxenesve-per-klase-dhe-ngarkesen-mesimore-te-punonjesve-arsimore.pdf>

4.4 Menaxhimi i godinave

4.4.1 Rikonstruksioni i objekteve

Gjatë analizës së situatës së arsimit parashkollor në Bashkinë Malësi e Madhe u evidentua se nga 32 kopshte publike, vetëm 11 prej tyre janë në godinë më vete. Pjesa tjetër e kopshteve publike, (21 prej tyre) e Njësi Administrative Kastrat, Gruemirë, Qendër, Shkrel, Kelmend janë akomoduar brenda godinave të shkollave.

Kopshtet në NjA Gruemirë kanë shprehur nevojën për rikonstruksion të kopshteve në fshatrat Gril, Hysaj, ndërkohë kopshtet e njësisë administrative Shkrel dhe Kastrat kanë raportuar më shumë nevojë për rikonstruksion të brendshëm dhe lysterje.

Objektiva specifike:

Rikonstruksioni i godinave duke iu përmbajtur standardeve për hapësirat e kopshteve dhe facilitetet e nevojshme.

Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Rikonstruksioni i godinave të kopshteve të cilat kanë nevojë për rikonstruksion
2	Mirëmbajtje e godinave të kopshteve

Lista e Aktiviteteve/Projekteve

Nr.	Projekti
017	Rikonstruksioni i Kopshtit Reç, etj
018	Mirëmbajtje e godinave të kopshteve

4.5 Materialet

4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale

Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr.48 / 2018. Neni 28: Njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore.

Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Hartimi i një liste të unifikuar të materialeve didaktike për të siguruar zhvillimin dhe të nxëniet e fëmijëve, bazuar në “Standartet e Zhvillimit dhe të të Nxëniet të fëmijëve 3-6 vjeç”

Lista e Aktiviteteve/Projekteve

Numri	Projekti
019	Unifikimi i listës së materialeve didaktike për të gjitha kopshtet e Bashkisë Malësi e Madhe

5. Buxheti për Arsimin parashkollor

Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parashkollor

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parashkollor në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifat vendore.

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore.

Për periudhën 2026–2028, buxheti total i planifikuar për Arsimin Parashkollor është 68,326.6 mijë Lekë, të detajuara sipas aktiviteteve më poshtë:

Aktivitetet	Viti 2026 (000 Lekë)	Viti 2027 (000 Lekë)	Viti 2028 (000 Lekë)
<i>Shpenzime per paga</i>	12,609.0	12,861.18	12,861.18
<i>Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore</i>	2,106.0	2,148.12	2,148.12
<i>Shpenzime operative</i>	3,328.6	3,523.2	3,609.6
<i>Shpenzime per investime</i>	3,889.4	4,116.8	5,125.4
Shuma në mijë Lekë	21,933	22,649.3	23,744.3

Plani i investimeve kapitale

Lista e projekteve të investimeve për periudhën afatmesme 2026 -2028 (në mijë Lekë)

Nr.	Emërtimi i Projektit	Viti 2026 (000 Lekë)	Viti 2027 (000 Lekë)	Viti 2028 (000 Lekë)
1	Rikonstrukcion i kopshteve	3,000	2,000	2,500
2	Investime për pajisje në godinat e arsimit parashkollor	789.4	2,016.8	2,525.4
3	Investime për rampa në godinat e arsimit parashkollor	100	100	100
	Shuma	3,889.4	4,116.8	5,125.4

Pjesa e dytë
Arsimi Parauniversitar
2026 - 2028

Përmbajtja - Pjesa e dytë

1. [Analiza e shërbimit në shkolla të nivelit bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025 .](#)
[Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit](#)
2. [Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar](#)
[Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve](#)
[Qëllimi 1 \(Q1\) Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurtë, modern dhe gjithëpërfshirës në çdo institucion shkollor të Bashkisë Malësi e Madhe](#)
[Qëllimi 2 \(Q2\) Zhvillimi i plotë i fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar në një sistem gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të tyre](#)
[Qëllimi 3 \(Q3\) Zhvillimi i aftësive, talenteve dhe ndjesisë së përkatësisë përmes veprimtarive jashtëkurrikulare dhe bashkëpunimit komunitar](#)
3. [Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar](#)
4. [Plani i Veprimit \(matrica e aktiviteteve\)](#)
5. [Monitorimi dhe vlerësimi](#)
6. [Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar](#)

Analiza e shërbimit në shkollat e nivelit bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025

Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit

Në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe janë të shpërndara gjithsej 27 institucione arsimore të niveleve të ndryshme, të cilat mbulojnë të gjitha njësitet administrative urbane dhe rurale të bashkisë. Këto institucione përfaqësojnë një rrjet të gjerë dhe të larmishëm të arsimit parauniversitar.

Ato klasifikohen në disa nivele sipas ciklit të edukimit që ofrojnë, duke përfshirë: shkolla fillore (4 gjithsej), shkolla 9-vjeçare (20 gjithsej) dhe shkolla të mesme të bashkuara (4 gjithsej).

-  **Shkollat fillore** u shërbejnë fëmijëve në fazat e para të edukimit, duke u ofruar njohuritë bazë në lexim, shkrim, matematikë dhe lëndë të tjera themelore. Ato janë të përhapura në mënyrë të tillë që të jenë sa më pranë vendbanimeve për të siguruar akses të lehtë për nxënësit e vegjël. Këto shkolla janë të përqendruara kryesisht në zona të thella malore dhe kanë një numër të ulët të fëmijëve të regjistruar për arsye të lëvizjeve demografike të popullsisë drejt zonave urbane.
-  **Shkollat 9-vjeçare**, gjithsej 20 në numër, përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor. Këto shkolla përbëjnë numrin më të madh të shkollave në territorin e bashkisë dhe kanë një shtrirje kapilare të mirë duke ofruar shërbim përfshirës për të gjithë fëmijët. Pavarësisht variacioneve, të dhënat për shkollat nënvizojnë rëndësinë e monitorimit të rregullt të pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim dhe nevojën për politika që mbështesin vazhdimësinë e shkollimit për të gjithë. Sigurimi i kushteve të favorshme për ndjekjen e arsimit 9-vjeçar është thelbësor për garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të barabartë për çdo fëmijë.
-  **Shkollat e mesme**, 3 gjimnaze, janë institucione që synojnë të formojnë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare apo për përgatitje për tregun e punës. Këto shkolla janë të vendosura në zona urbane të bashkisë për të përfshirë një numër sa më të madh nxënësish nga zona të ndryshme të bashkisë. Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga faktorë të shumtë si zgjedhjet individuale, mundësitë për të ndjekur shkolla të përgjithshme apo profesionale, si dhe faktorë socialë, ekonomikë apo kulturorë. Kjo e bën të nevojshme që të mbështetet përfshirja e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në këtë nivel të rëndësishëm të arsimit.

Në tërësi, rrjeti arsimor i Bashkisë është konceptuar për të siguruar mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit apo kushteve ekonomike.

Mëposhtë paraqesim tabelën e shkollave sipas njësive administrative, llojit, kapacitetit dhe numrit të fëmijëve të regjistruar. Nga tabela vërejmë se ka një shpërndarje të mirë të shkollave me të gjitha ciklet e arsimit në të gjitha njësitet administrative në territorin e Bashkisë. Të dhënat e mbledhura nga shkollat na tregojnë se në të gjitha shkollat kapacitetet akomoduese janë të mjaftueshme për të ofruar një shërbim cilësor për të gjithë fëmijët në të gjithë territorin dhe nuk ka nevojë për të ndërtuar struktura të reja. Përqëndrimin më të madh të fëmijëve e gjejmë në zonat me një përqëndrim urban me të madh që janë edhe qendrat e njësive administrative si Kopliku, Bajza, Boriç i Madh, Grizhë dhe Dedaj ku përqendrohet numri më i lartë i fëmijëve 1087, ose 64% e fëmijëve të regjistruar në të

gjithë bashkinë. Shkollat e tjera që janë të shpërndara nëpër fshatra në zonat rurale dhe zonat e thella malore kanë një numër më të vogël fëmijësh të regjistruar. Ka shkolla që kanë më pak se 10 fëmijë të regjistruar, për shkak të lëvizjeve demografike të viteve të fundit, për të cilat bashkia do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë.

Nr	Emri i Shkolles	Njësia Administrative	Qytet/Fshat	Lloji i Shkolles	Kapaciteti akomodues	Numri total i fëmijëve të regjistruar	Vajza
1	Abdyl Bajraktari	Koplik	Koplik	AMU	550	426	208
7	Stërbeq	Qender	Stërbeq	AMU	50	31	14
8	Kamicë	Qender	Kamicë	AMU	70	42	21
9	Ilir Dashi	Qender	Koplik i Sipërm	AMU	250	58	36
2	Prekë Gjoni	Kastrat	Bajzë	AMU	500	213	106
3	Fran Murrizi	Kastrat	Pjetroshan	AMU	150	38	22
4	Permal	Kastrat	Permal	AF	60	5	2
5	Ded Gjon Luli	Kastrat	Hot	SHMB	250	56	18
6	Kolë Maçi	Kastrat	Rapshë	AMU	100	33	13
10	Muhamet Hasmuja	Gruemirë	Grizhe	AMU	500	116	0
11	Myftar Mataj	Gruemirë	Gruemirë	AMU	400	74	33
12	Hysaj	Gruemirë	Hysaj	AMU	300	25	13
13	Linaj	Gruemirë	Linaj	AMU	100	8	4
14	Vajush	Gruemirë	Vajush	AMU	10	1	0
15	Vasil Shanto	Gruemire	Boriç I Madh	AMU	400	214	109
16	Rifat Nuzi	Shkrel	Reç	SHMB	120	90	46
17	Migjeni	Shkrel	Zagorë	AMU	200	32	12
18	Bratosh	Shkrel	Bratosh	AMU	200	31	15
19	Vrith	Shkrel	Vrith	AMU	200	12	2
20	Kolë Martini	Shkrel	Dedaj	SHMB	300	118	46
21	Nikç	Kelmend	Nikç	AMU	60	4	0
22	Muriq	Kelmend	Muriq	AF	40	11	4
23	Kuvendi I Greces	Kelmend	Selcë	AMU	200	30	14
24	Demokracia	Kelmend	Vermosh	AMU	200	15	5
25	Lëpushë	Kelmend	Lëpushë	AMU	40	1	1
26	Velan	Kelmend	Velan	AF	20	5	2
27	Velipojë	Kelmend	Velipojë	AF	20	1	1

Sipas të dhënave të raportuara në tabelën mësipër, nga 1690 fëmijë të rregjistruar në shkolla 44% janë vajza. Kjo ndarje ndryshon nga njësia në njësi, në varësi të kushteve lokale, demografisë, dhe mundësive të ofruara në komunitet. Të dhënat nënvizojnë rëndësinë e vazhdim të përpjekjeve për të garantuar akses të barabartë dhe gjithëpërfshirës në arsimin fillor për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit apo karakteristikave të tjera sociale. Sigurimi i kushteve të përshtatshme për ndjekjen e shkollës dhe mbështetja institucionale mbeten faktorë kyç për përmirësimin e mëtejshëm të përfshirjes.

Tabela e shpërndarjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve familja e të cilëve është me ndihmë ekonomike.

Nr	Emri i Shkolles	Njësia Administrative	Qytet/Fshat	Lloji i Shkolles	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të aspektit mendore	Fëmijë me AK që kanë Program Edukativ Individual	Numri i fëmijëve që familja është me ndihmë ekonomike	Numri i fëmijëve që familja është me ndihmë ekonomike(vajza)
1	Abdyl Bajraktari	Koplik	Koplik	AMU	9	9	27	15
7	Stërbeq	Qender	Stërbeq	AMU	0	0	20	9
8	Kamicë	Qender	Kamicë	AMU	1	1	22	16
9	Illir Dashi	Qender	Koplik i Sipërm	AMU	0	0	20	12
2	Prekë Gjoni	Kastrat	Bajzë	AMU	1	1	25	13
3	Fran Murrizi	Kastrat	Pjetroschan	AMU	2	2	15	8
4	Permal Ded Gjon	Kastrat	Permal	AF	0	0	0	0
5	Luli	Kastrat	Hot	SHMB	0	0	10	8
6	Kolë Maçi Muhamet	Kastrat	Rapshë	AMU	2	1	7	3
10	Hasmuja	Gruemirë	Grizhe	AMU	3	3	14	7
11	Myftar Mataj	Gruemirë	Gruemirë	AMU	0	0	20	20
12	Hysaj	Gruemirë	Hysaj	AMU	0	0	10	8
13	Linaj	Gruemirë	Linaj	AMU	0	0	8	4
14	Vajush	Gruemirë	Vajush	AMU	0	0	1	0
15	Vasil Shanto	Gruemire	Boriç I Madh	AMU	1	1	23	12
16	Rifat Nuzi	Shkrel	Reç	SHMB	1	1	38	16
17	Migjeni	Shkrel	Zagorë	AMU	0	0	12	6
18	Bratosh	Shkrel	Bratosh	AMU	0	0	7	3
19	Vrith Kolë	Shkrel	Vrith	AMU	0	0	5	2
20	Martini	Shkrel	Dedaj	SHMB	2	2	37	12
21	Nikç	Kelmend	Nikç	AMU	0	0	3	0
22	Muriq Kuvendi I	Kelmend	Muriq	AF	0	0	7	2
23	Greces	Kelmend	Selcë	AMU	0	0	12	5
24	Demokracia	Kelmend	Vermosh	AMU	0	0	5	3
25	Lëpushë	Kelmend	Lëpushë	AMU	0	0	1	1
26	Velan	Kelmend	Velan	AF	0	0	3	1
27	Velipojë	Kelmend	Velipojë	AF	0	0	1	0

Shkollat e Bashkisë kanë të regjistruar 22 fëmijë me aftësi të kufizuara (2 vajza), nga të cilët 21 kanë program edukativ individual dhe janë 16 mësues ndihmës që punojnë. Kjo tregon kujdesin që bashkia tregon dhe do të tregojë për këtë kategori të veçantë. Pjesa më madhe e këtyre fëmijëve janë të përqendruar në Koplik, 9 fëmijë në Shkollën Abdyl Bajraktari, pjesa tjetër është e shpërndarë në shkollat e tjera të Njësive administrative.

Në shkollat e Bashkisë Malësi e Madhe janë 353 fëmijë (186 vajza) familjet e të cilëve mbështeten me ndihmë ekonomike të shpërndarë në të gjithë fshatrat, nga zonat urbane te zonat e thella malore.

Tabela e numrit të mësuesve sipas shkollave dhe nivelit arsimor të tyre.

Nr	Emri i Shkolles	Njësia Administrative	Qytet/Fshat	Lloji i Shkolles	Numri i mësueseve me arsim të mesëm jo pedagogjik	Numri i mësueseve me arsim të mesëm pedagogjik	Numri i mësueseve me arsim të lartë	Numri total i mësueseve	Numri i mësueseve ndihmës
1	Abdyl Bajraktari	Koplik	Koplik	AMU	0	0	37	37	5
7	Stërbeq	Qender	Stërbeq	AMU	0	0	9	9	0
8	Kamicë	Qender	Kamicë	AMU	0	0	7	7	1
9	Illir Dashi	Qender	Koplik i Sipërm	AMU	0	0	12	13	1
2	Prekë Gjoni	Kastrat	Bajzë	AMU	0	0	21	23	2
3	Fran Murrizi	Kastrat	Pjetroshan	AMU	0	1	9	10	1
4	Permal Ded Gjon	Kastrat	Permal	AF	0	0	1	1	0
5	Luli	Kastrat	Hot	SHMB	0	0	12	0	0
6	Kolë Maçi Muhamet	Kastrat	Rapshë	AMU	0	0	3	0	0
10	Hasmuja	Gruemirë	Grizhe	AMU	0	0	17	20	3
11	Myftar Mataj	Gruemirë	Gruemirë	AMU	0	0	15	15	0
12	Hysaj	Gruemirë	Hysaj	AMU	0	0	7	7	0
13	Linaj	Gruemirë	Linaj	AMU	0	0	5	5	0
14	Vajush	Gruemirë	Vajush	AMU	0	0	1	1	0
15	Vasil Shanto	Gruemire	Boriç I Madh	AMU	0	3	20	23	1
16	Rifat Nuzi	Shkrel	Reç	SHMB	0	0	13	13	1
17	Migjeni	Shkrel	Zagorë	AMU	0	0	10	10	0
18	Bratosh	Shkrel	Bratosh	AMU	0	0	10	10	0
19	Vrith	Shkrel	Vrith	AMU	0	0	10	10	0
20	Kolë Martini	Shkrel	Dedaj	SHMB	0	0	20	21	1
21	Nikç	Kelmend	Nikç	AMU	1	0	0	1	0
22	Muriq Kuvendi I	Kelmend	Muriq	AF	1	0	1	2	0
23	Greces	Kelmend	Selcë	AMU	1	1	3	5	0
24	Demokracia	Kelmend	Vermosh	AMU	3	1	2	6	0
25	Lëpushë	Kelmend	Lëpushë	AMU	0	0	0	1	0
26	Velan	Kelmend	Velan	AF	1	0	0	1	0
27	Velipojë	Kelmend	Velipojë	AF	1	0	0	1	0

Në shkollat e Bashkisë Malësi e Madhe ofrojnë shërbim arsimor 245 mësues, pjesa më e madhe e të cilëve është me arsim të lartë pedagogjik. Vetëm 14 mësues nuk e kanë arsimin e lartë pedagogjik, pothuajse të gjithë të përqendruar në zona të thella malore dhe në shkolla të frekuentuara nga pak fëmijë. Numrit të mësuesve u shtohen edhe 16 mësues ndihmës që ofrojnë shërbim për fëmijët me aftësi të kufizuara të përqendruar kryesisht në shkollat e zonave urbane.

Nga të dhënat në dispozicion të bashkisë mbi 95% e mësuesve kanë mbi 6 vjet ekperience pune në arsim duke treguar se territori mbulohet nga mësues me përvojë.

Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar

Vizioni

“Të garantojmë akses të barabartë, cilësi të lartë dhe përfshirje të plotë në arsimin parauniversitar për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe – duke përmirësuar e modernizuar shërbimin në shkolla si qendra komunitare që formësojnë qytetarë të denjë dhe të përgatitur për të ardhmen.”

Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve

Duke u mbështetur në rrjetin ekzistues të institucioneve arsimore, nga kopshtet deri në shkollat e mesme dhe duke adresuar sfidat aktuale të aksesit, infrastrukturës dhe përfshirjes gjinore, Bashkia Malësi e Madhe ka për synim:

- **Vlerësimin dhe përmirësimin e infrastrukturës arsimore**, për të garantuar kushte dinjitoze mësimi në çdo shkollë;
- **Forcimi i përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta**, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
- **Rritjen e cilësisë së mësimdhënies**, përmes investimit në zhvillimin profesional të mësuesve dhe përdorimin e metodologjive bashkëkohore;
- **Forcimin e partneriteteve me komunitetin dhe institucionet arsimore** për të mbështetur suksesin e çdo nxënësi.
- **Rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së komunitetit**
 - **Fushata informuese dhe edukative për prindërit**, veçanërisht në lagje ose fshatra ku ka mungesë informacioni mbi rëndësinë e edukimit të hershëm.
 - **Bashkëpunim me punonjësit socialë dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës** për të identifikuar dhe mbështetur familjet në vështirësi ekonomike ose sociale.
 - **Angazhimi i këshillave të prindërve dhe organizatave lokale**, për të fuqizuar përfshirjen dhe monitorimin e komunitetit.

Qëllimi 1 (Q1) Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurtë, modern dhe gjithëpërfshirës në çdo institucion shkollor të Bashkisë Malësi e Madhe

Bashkia Malësi e Madhe synon të garantojë kushte infrastrukturore të qëndrueshme dhe funksionale për çdo institucion arsimor në territorin e saj, përmes mirëmbajtjes së rregullt dhe investimeve që përmbushin standardet bashkëkohore të sigurisë, higjienës dhe funksionalitetit.

- **Objektivi 1.1:** Të sigurohet ofrimi i pandërprerë i shërbimeve mbështetëse për institucionet arsimore, duke përfshirë: pagesat për personelin edukativ dhe ndihmës, mirëmbajtjen e ambienteve, përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, funksionimin e sistemeve të ngrohjes, furnizimin me kancelari dhe transport.
- **Objektivi 1.2:** Të realizohen investime prioritare në ndërtimin, rikonstruksionin dhe pajisjen e shkollave, si dhe ngritjen e një sistemi dixhital për menaxhimin dhe transparencën e të dhënave institucionale.

Qëllimi 2 (Q2) Zhvillimi i plotë i fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar në një sistem gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të tyre

Përmes një qasjeje të balancuar mes edukimit, përkujdesjes dhe përfshirjes sociale, Bashkia Malësi e Madhe synon të nxisë zhvillimin e gjithanshëm të fëmijëve, veçanërisht të atyre që përballen me barriera sociale, ekonomike apo zhvillimore.

- **Objektivi 2.1:** Të përmirësohet cilësia e edukimit në shkollat fillore përmes sigurimit të mjeteve didaktike bashkëkohore dhe trajnimit të vazhdueshëm të stafit pedagogjik.
- **Objektivi 2.2:** Të zgjerohet ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes psiko-sociale dhe të angazhohen mësues ndihmës për të mbështetur fëmijët me nevoja të veçanta ose në rrezik social.
- **Objektivi 2.3:** Të forcohet ndërveprimi shkollë–familje–komunitet përmes strukturave të përfaqësimit (këshillat e prindërve, bordet shkollore) dhe aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin për promovimin e barazisë dhe përfshirjes.

Qëllimi 3 (Q3) Zhvillimi i aftësive, talenteve dhe ndjesisë së përkatësisë përmes veprimtarive jashtëkurrikulare dhe bashkëpunimit komunitar

Bashkia Malësi e Madhe e konsideron edukimin përmes kulturës, artit, sportit dhe përvojave sociale si pjesë të pandashme të zhvillimit të fëmijëve dhe forcimit të lidhjes së tyre me komunitetin lokal.

- **Objektivi 3.1:** Të zhvillohet një kalendar i rregullt aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale për fëmijët në institucionet arsimore, për të nxitur kreativitetin, bashkëpunimin dhe ndjesinë e përkatësisë, në bashkëpunim me institucione kulturore, sportive dhe artistike në qytet për të krijuar sinergji dhe mundësi të reja edukative për fëmijët.

Përmbledhje e investimeve kapitale (2026–2028)

Plani i arsimit parauniversitar i Bashkisë Malësi e Madhe parashikon ndërhyrje me investime kapitale të rëndësishme, të cilat synojnë përmirësimin rrënjësor të infrastrukturës arsimore dhe forcimin e kapaciteteve teknike e pedagogjike të institucioneve.

Gjatë periudhës 2026–2028, investimet do të fokusohen në rikonstruksionin e shkollave të arsimit bazë, parashkollor dhe të mesëm, pajisjen e ambienteve me infrastrukturë moderne, si dhe ngritjen e kushteve të përshtatshme për mësimdhënie dhe zhvillim gjithëpërfshirës të nxënësve. Plani kapital synon të garantojë ambiente të sigurt, funksionale dhe të përshtatshme për nevojat e fëmijëve dhe të rinjve në çdo nivel të arsimit parauniversitar. Këto ndërhyrje janë pjesë e një vizioni afatgjatë për transformimin e shkollës në një hapësirë që promovon cilësi, barazi dhe zhvillim të qëndrueshëm arsimor në territorin e Bashkisë.

Një nga projektet më të mëdha financiare është rikonstruksioni i shkollave të arsimit bazë dhe parashkollor. Këto investime synojnë të përmirësojnë ndjeshëm mjediset mësimore dhe të rrisin sigurinë dhe funksionalitetin e institucioneve.

Përveç rikonstruksionit, janë planifikuar edhe investime për pajisje në godinat e shkollave të arsimit bazë dhe parashkollor, duke përfshirë mjete didaktike, teknologji mësimore dhe mobilie që përmirësojnë përvojën edukative të nxënësve.

Në nivelin e arsimit të mesëm parauniversitar, plani parashikon rikonstrukcion të shkollave si ajo e shkollës së mesme të bashkuar “Rifat Nuzi” në Reç etj. Ky plan do të fokusohet në rritjen e cilësisë së ambienteve të të nxënit në gjimnazet e bashkisë.

Këto investime paraqesin një angazhim të qartë të Bashkisë Malësi e Madhe për modernizimin e sistemit arsimor lokal dhe për përmirësimin e cilësisë së edukimit në të gjithë territorin e saj, në përputhje me standardet bashkëkohore dhe nevojat e komunitetit.

Planifikimi Afatmesëm Buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar

Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parauniversitar

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifat vendore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi 9-vjeçar, Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave.
- Funksionimin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve ose njësi të tjera mbështetëse të edukimit jashtëshkollor, duke përfshirë pagat e personelit mësues dhe ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës.

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore.

Për periudhën 2025–2028, buxheti total i planifikuar për Arsimin Bazë është 535,539.4 mijë lekë, të detajuara sipas aktiviteteve më poshtë:

Aktivitetet	Viti 2025 në mijë Lekë	Viti 2026 në mijë Lekë	Viti 2027 në mijë Lekë	Viti 2028 në mijë Lekë
<i>Shpenzime për paga</i>	82,932	86,332	91,383	93,622
<i>Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore</i>	13,850	14,418	15,261	15,635
<i>Shpenzime operative</i>	12,789.6	13,314.4	14,092.8	14,438.4
<i>Shpenzime për investime</i>	14,944.8	15,557.6	16,467.2	20,501.6
Shuma në mijë Lekë	124,516.4	129,622	137,204	144,197

Për periudhën 2025–2028, buxheti total i planifikuar për Arsimin e mesëm të përgjithshëm është 193,954 mijë lekë, të detajuara sipas aktiviteteve më poshtë:

Aktivitetet	Viti 2025 në mijë Lekë	Viti 2026 në mijë Lekë	Viti 2027 në mijë Lekë	Viti 2028 në mijë Lekë	Shuma në mijë Lekë
<i>Shpenzime për paga</i>	8,040	8,370	8,860	9,076	34,346
<i>Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore</i>	1,343	1,398	1,480	1,516	5,737
<i>Shpenzime operative</i>	8,371	8,714	9,224	9,450	35,759
<i>Shpenzime për investime</i>	26,161	27,234	28,827	35,890	118,112
Shuma në mijë Lekë	43,915	45,716	48,391	55,932	193,954

Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

Qëllimi 1 (Q1) Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurtë, modern dhe gjithëpërfshirës në çdo institucion shkollor të Bashkisë

Objektivi specific O1. Të sigurohet ofrimi i shërbimeve mbështetëse në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive, duke përfshirë pagesat e personelit mësues në arsimin parashkollor dhe personelit ndihmës në kopshte dhe shkolla, mirëmbajtjen e ambienteve shkollore, përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, funksionimin e sistemeve të ngrohjes, furnizimin me kancelari, mjete didaktike, ushqim, dokumentacion dhe transport.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Mbështetja me pagesën dhe sigurimin punonjësve e arsimit bazë dhe atij të mesëm	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Këshilli Bashkiak	Transferte specifike + Buxhet vendor	Nr. i punonjësve të mbështetur financiarisht; Nr. i fëmijëve të regjistruar (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel)
Mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastruktures arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet;	Shkollat	Buxhet vendor + transferte e pakushtëzuar	Nr. ndërhyrjeve të realizuara në godina (Lyerje, ndarje ambientesh, mirëmbajtje kaldajash, elektroshtepiakësh, kompjuterash, printerash, paisjesh të zyrave)
Garantimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve higjieno-sanitare	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Shkollat, operatorë të higjenës	Buxhet vendor, transferte e pakushtëzuar	Nr. i shkollave me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare
Sigurimi i sistemit të ngrohjes funksional për të gjitha institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Operatorë të energjisë,	Buxhet vendor + transferte specifike	Nr. i institucioneve me sistem funksional ngrohjeje
Furnizimi me kancelari për institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i institucioneve të furnizuara me kancelari
Furnizimi, kontrolli dhe kolaudimi i fikseve të zjarrit	2026–2028	Zyra e Emergjencave	Zjarrfikësja, NjA	Buxhet vendor	Nr. i fikseve të vendosura dhe funksionale

Furnizimi me dokumentacion administrativ për institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i shkollave të pajisura me dokumentacion
Furnizimi me mjete didaktike për institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat, MAS	Buxhet vendor + donacione, prindërit	Nr. i institucioneve të pajisura me mjete didaktike
Kryerja e shërbimit të dezinfektimit në institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), operatorë të kontraktuar	Buxhet vendor + fond emergjence	Nr. i dezinfektimeve të kryera në vit
Ofrimi dhe sigurimi i shërbimit të transportit për mirëadministrimin dhe shërbimet për institucionet arsimore	Çdo vit	ZVA	Drejtoria e Transporteve, administrata	Buxheti i Bashkisë	Shpenzime për karburant, siguracione, pjesë këmbimi për automjete të shërbimit, dhe udhëtime për administratën

Objektivi specifik O1.2 Të realizohen investime prioritare në ndërtimin, rikonstrukcionin dhe pajisjen e kopshteve dhe shkollave, si dhe ngritjen e një sistemi dixhital për menaxhimin dhe transparencën e të dhënave institucionale.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit baazë Rikonstrukcion i shkollave të arsimit bazë	Çdo vit 2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve të arsimit bazë të rikonstruktura; Përmirësim i kushteve
Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit të mesëm Rikonstrukcion i shkollave të arsimit të mesëm	Çdo vit 2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Drejtoria e Arsimit	Buxheti i Bashkisë, Bashkefinancim me Qeverinë Shqiptare	Nr. i infrastukturës shkollore të arsimit të mesëm të përgjithshëm e rikonstruktuar
Investime për pajisje në godinat e shkollave të arsimit parauniversitar	Çdo vit 2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve të arsimit bazë të rikonstruktura; Përmirësim i kushteve
Ndërtim i një sistemi të dhënash digjitale për shkollat në kuadër të planit për përmirësim të arsimit parauniversitar	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Kopshtet/shkollat; Ekspertë të jashtëm për mbështetje	Buxheti i Bashkisë (orë pune punonjës të angazhuar në punë)	Një regjistër i shërbimit për arsimin baze dhe atë të mesëm i krijuar, dhe i përditësuar çdo vit me të dhëna

Qëllimi 2 (Q2) – Zhvillimi i plotë i fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar në një sistem gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të tyre

Objektivi specifik O2.1 Të zgjerohet ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes psiko-sociale dhe të angazhohen mësues ndihmës për të mbështetur fëmijët me nevoja të veçanta ose në rrezik social.					
Aktivitete	Periudha zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në shkollat.	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin	Administratorët e Njësive Administrative; këshilli bashkiak; Prindërit	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Struktura menaxhuese në shkolla aktive Pjesëmarrja e balancuar gjinore e prindërve (nënë/baba) në strukturat menaxhuese të shkollave
Ofrimi i shërbimit psiko-social në shkolla	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	Shkollat OSHC	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) të mbështetur me shërbim psiko social
Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	Shkollat, Njësitë Administrative, OJQ	Buxhet vendor + donacione + projekte sociale	Nr. i nxënësve (vajza/djem) nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel të mbështetur
Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin. Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	MAS, mësues, komuniteti	Buxhet vendor + shpërblime nga MAS	Nr. i nxënësve (vajza/djem) me rezultate të shkëlqyera të mbështetur

Objektivi specifik O2.3 Të forcohet ndërveprimi shkollë–familje–komunitet përmes strukturave të përfaqësimit (këshillat e prindërve, bordet shkollore) dhe aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin për promovimin e barazisë dhe përfshirjes.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Organizimi i fushatave informuese dhe edukative për prindërit dhe kujdestarët, veçanërisht në lagje dhe fshatra me mungesë informacioni mbi rëndësinë e edukimit të hershëm.	2026, 2027, 2028	Drejtorja e Arsimit në Bashki	Drejtoria e Shëndetësisë, OJF lokale, Këshillat e Prindërve	Zëri 602 – Mallra dhe shërbime; Donatorë lokalë OSHC	- Numri i fushatave të realizuara - Numri i prindërve të informuar
Nxitja e përfshirjes së këshillave të prindërve dhe organizatave komunitare lokale në proceset vendimmarrëse, planifikuese dhe monitoruese të shërbimit arsimor, me qëllim rritjen e transparencës dhe bashkëpronësisë	Tremujori I–IV 2026, 2027, 2028 (proces i vazhdueshëm)	Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Bordi i Shkollës, Këshillat e Prindërve, Komuniteti lokal	Zëri 600 dhe 606 – Orë pune, mbledhje dhe aktivitete komunitare	- Numri i këshillave funksionale - Frekuentimi i takimeve - Propozime të komunitetit të reflektuara në vendimmarrje

Qëllimi 3 (Q3)– Zhvillimi i aftësive, talenteve dhe ndjesisë së përkatësisë përmes veprimtarive jashtëkurrikulare dhe bashkëpunimit komunitar

Objektivi specifik O3.1 Të inkurajohet bashkëpunimi me institucione kulturore, sportive dhe artistike në qytet për të krijuar sinergji dhe mundësi të reja edukative për fëmijët.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit:	Çdo vit	Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Prindër, OJQ	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktiviteteve; përfshirje gjithëpërfshirëse
1. Fushata “Dhuro një libër, hap një dritare” (me bashkëpunimin e institucioneve kulturore)	Prill	Drejtorja e Arsimit dhe	Qendra Kulturore,	Mbështetje donatorësh, Buxhet vendor	Numri i librave të dhuruar; numri i fëmijëve të përfshirë

		Institucionet Arsimore	Biblioteka, Prindër		
2. Aktivitet në hapësira publike me mbështetjen e institucioneve vendore ✚ Ekspozitë me punime, vizatime dhe postera	Maj–Qershor	Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Bashkia, Drejtorja e Kulturës, Policia Bashkiake	Bashkia, partnerë lokalë	Numri i fëmijëve pjesëmarrës; numri i punimeve ekspozuar
3. Marshim festiv me bashkëpunim ndërsektorial për Festat Kombëtare	Nëntor	Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Bashkia, Drejtorja e Arsimit, Policia Bashkiake, MAS	Buxhet vendor, sponsorizime private	Numri i pjesëmarrësve; vlerësim nga prindërit dhe publiku



Bashkia Malësi e Madhe

Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjikë. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktivitetsesh në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm. Këta përfshijnë:

- Numrin e institucioneve të rikonstruara ose me kushte të përmirësuara.
- Numrin i kopshteve (hapësirave) të reja funksionale.
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë.
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar.
- Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë.
- Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to.
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale).
- Eficienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore.

Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara.
- Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi.
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren.
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxënës.
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- Ekspertë të pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike.
- Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale.
- Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore.
- Njësitë e statistikës/performances dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave.
- Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

1. **Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara**
2. **Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor**

Monitorimi i realizimit të aktiviteteve

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:

- **0** – Aktiviteti nuk ka nisur.
- **1–9** – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.
- **10** – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Për secilin objektiv strategjik të planit, do të përcaktohet numri total i pikëve maksimale, duke shumëzuar numrin e aktiviteteve të planifikuara për objektivin përkatës me 10 (p.sh., 5 aktivitete $\times 10 = 50$ pikë maksimale për objektivin).

Gjatë zbatimit, pikët reale të arritura për çdo aktivitet do të regjistrohen, dhe më pas do të përmbledhen në nivel objektiv. Kjo do të mundësojë llogaritjen e përqindjes së realizimit të secilit objektiv në kohë reale:

Perqindja e realizimit të objektivit = (Pike të realizuara / Piket maksimale) $\times 100$

Ky mekanizëm do të sigurojë një vlerësim të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për zbatimin e planit përgjatë viteve.

Vlerësimi i ndikimit në komunitet

Për të matur ndikimin e aktiviteteve në komunitet, do të monitorohet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe fëmijëve në zbatimin e tyre.

Për çdo aktivitet do të vendosen targete të matshme:

- Numri i kopshteve dhe shkollave të synuara.
- Numri i fëmijëve të parashikuar për përfshirje (në kopsht dhe shkollë, sipas rastit).

Në përfundim të zbatimit të çdo aktiviteti, do të regjistrohet:

- Numri real i institucioneve që morën pjesë (në kopsht ose shkollë).
- Numri real i fëmijëve të përfshirë.

Në rastet kur aktiviteti synon vetëm një kategori (p.sh. vetëm kopshtet), pjesëmarrja për kategorinë tjetër do të konsiderohet.

Për çdo aktivitet do të llogaritet përqindja e pjesëmarrjes së arritur sipas formulës:

Perqindja e pjesëmarrjes = (Numri real i pjesëmarrësve / Numri target) $\times 100$

Ky tregues do të ndihmojë në vlerësimin e shkallës së përfshirjes dhe impaktit që ka pasur secili aktivitet në komunitetin arsimor.

Rishikimi dhe përshtatja e planit

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Malësi e Madhe. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Procesi i rishikimit

Rishikimi i planit do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të paracaktuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë periodike efektiviteti i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra. Planifikohen këto forma rishikimi:

- **Rishikimi vjetor** – i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit.
- **Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2027)** – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028.
- **Rishikime të jashtëzakonshme**, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).

Ky proces do të kryhet në mënyrë të ndërsektoriale, me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse, përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë.

Përshtatja e masave dhe aktiviteteve

Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi dhe vlerësimi i planit, si dhe në konsultimet me komunitetin arsimor, do të ndërmerren përshtatje të nevojshme në:

- **Aktivitete konkrete** – duke përmirësuar përmbajtjen, kohëzgjatjen, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit.
- **Alokimin e burimeve** – në rast se disa fusha kërkojnë më shumë mbështetje për të arritur objektivat.
- **Prioritetet vjetore** – në përputhje me nevojat emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit lokal.
- **Metodologjinë e zbatimit** – duke integruar praktikat më të mira dhe rekomandimet e vlerësimeve të jashtme.

Ky fleksibilitet në përshtatje synon të sigurojë që plani të mos mbetet një dokument statik, por të jetë një **instrument dinamik, funksional dhe i orientuar drejt rezultateve reale** për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Malësi e Madhe.

Raportimi dhe transparenca

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparenca, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe

mundësimit të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar

Kuadri Kushtetues dhe Ligjor i përgjithshëm

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 57, pika 1
- Ligji Nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2018
- Ligji Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligji Nr. 9936/2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligji Nr. 9632/2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”
- Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”
- Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024, “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”
- Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit”

Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- Ligji Nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025
- Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”
- Udhëzim i përbashkët MAS–MSHMS nr. 658, datë 23.09.2019, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

Shërbimi psiko-Social dhe ërfshirja Sociale

- Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar”
- Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore